

FRUTI MË I ËMBËL



DEMOKRACIA

DEMOKRACIA BAZA E SHTETIT

VESA (11), MEDINA (11), ELSA (11), SONILA (10), DRIN (10), BLEART (10), LEONARD (11)



Ne të gjithë mund të mësojmë nga njëri-tjetri. Mësoni edhe ju nga ne se si duhet të solidarizohemi me të tjerët në demokraci

Një ditë mësuesja jonë hyri në klasë dhe dukej e mërzitur. Ajo na tregoi se një nxënës është sëmurë dhe ka



nevojë për ndihmën tonë. Ne gjithashtu u mërzitëm nga ky lajm. Por, nuk hezituaam t'i ndihmonim. Mblodhëm të holla dhe ia dorëzuam mësuesës tonë. Më pas, ajo i dhuroi ato në emrin tonë, për nxënësin në nevojë. Kjo nuk ishte hera e parë që ne si klasë jemi mobilizuar dhe kemi ofruar ndihmë për këdo që ka pasur nevojë.

Një herë tjetër, mësuesja na njoftoi se nëse kemi dëshirë, mund të mbledhim rroba, lodra, libra, dhe çkado tjetër, që t'ua dërgojmë moshatarëve tanë me kushte më të vështira ekonomike.

Ne me shumë entuziazëm mblodhëm gjithçka që kishim dhe donim t'ua dhuronim. Kjo që ne kemi bërë quhet solidaritet. Pra, ne jemi solidarizuar me qytetarët të cilët kanë pasur nevojë për ndihmën tonë. E solidariteti është një ndër elementet më të rëndësishme të demokracisë. Elementet e tjera të demokracisë janë: liria, paqja, toleranca, barazia, etj. Secila nga këto elemente është pjesë e jetës sonë. Falë tyre, ne jetojmë këtë jetë të qetë, në paqe dhe duke i gëzuar të gjithë të drejtat që i kemi. Kështu duhet të veprojmë gjithmonë. Vetëm në këtë mënyrë do të jemi ne ata të cilët ndikojmë në zhvillimin e demokracisë.

Për të kuptuar më shumë se ku ka lindur demokracia, dhe si ka qenë atëherë e si është sot, ne ju ftojmë të lexoni faqen tjetër. Nuk do të zhgënjeheni nga informatat tona.




Ne, gazetarët e këtij artikulli

Kjo faqe është e punuar nga dy grupe. Pjesa e parë, ashtu edhe siç iu premtuam, flet për demokracinë dhe historikun e saj

Atëherë, faleminderit që po vazhdoni të lexoni artikullin tonë. „Ku u paraqit demokracia për herë të parë?“, është pyetja e parë që na bie ndërmend menjëherë kur përmendet fjala demokraci. Kjo formë e qeverisjes, e cila sipas nesh është forma më e mirë, është paraqitur për herë të parë në Athinë. Athina është kryeqyteti i Greqisë. Mirëpo, duhet ditur se demokracia jo gjithmonë ka qenë kështu si sot. Në vitin 507 p.e.s. kur qytetarët e Greqisë e zbuluan dhe zhvilluan demokracinë, nuk kishte barazi. Të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur. Askush nuk pyeste për mendimin e të moshuarve, grave apo personave me kushte më të vështira ekonomike.

Për fat të mirë, me kalimin e kohës njerëzit e kuptuan se barazia është e domosdoshme. Kështu, meqë demokracia është udhëheqje e popullit, sot të gjithë pa asnjë dallim udhëheqim. Këtë e bëjmë përmes votave tona.



Shkolla, institucioni më i dashur për ne. Aty fitojmë dituri dhe krijojmë shoqëri të reja

Mirëseerdhët në pjesën e dytë të kësaj faqeje. Më poshtë mund të gjeni vetëm një pjesë të punës sonë. Kuptojeni rëndësinë e zgjedhjeve. Për më shumë, lexoni artikullin „Zgjedhjet në mesin e jetës sonë“

Ne do të mundohemi t'i përgjigjemi pyetjes pse zgjedhjet janë të rëndësishme për jetën tonë. Pavarësisht se kemi shumë zgjedhje në jetën e përditshme, disa prej tyre janë më të vështira e disa më të lehta. Për të zgjedhur një libër është më lehtë sesa të zgjedhim kandidatin/en të cilin/en dëshirojmë të zgjedhim për të udhëhequr në vendin tonë. Për këtë arsye, ne duhet të bëjmë shumë kujdes në zgjedhjet tona të rëndësish-

me. Personat të cilët marrin votat tona, punojnë për ne, sepse ata janë zëri ynë. E ne jemi e ardhmja e tyre dhe e ardhmja e institucioneve tona vendimmarrëse. Shpresojmë që kur të arrijmë moshën e duhur, të jemi të sigurtë në zgjedhjet që do t'i bëjmë. Për këtë, na duhet të mësojmë shumë dhe të bëhemi qytetarë të ndershëm. Ju ftojme edhe juve, lexues të dashur, të bëheni të tillë.




Këto vizatime tregojnë se sa të përkushtuar kemi qenë sot. Jemi shumë të lumtur që patëm mundësinë të jemi gazetarë e sidomos gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Ne e kemi kuptuar rëndësinë e procesit zgjedhor në jetën tonë. Andaj, duke votuar bëjmë ndryshimin që duam të shohim në vendin tonë. Vota është vula e ndryshimit

ZGJEDHJET NË MESIN E JETËS SONË

GERSI (10), DINETA (11), VIGAN (10), ERZA (11), LINA (10), ALENA (11)

Ne me klasën tonë erdhëm në organizatën jo qeveritare TOKA, më saktë në Punëtorinë e Demokracisë më të mirë në botë të quajtur „Demos-ti“. Në këtë artikull do të flasim për zgjedhjet në jetën dhe në shtetin tonë. Ne ju ftojmë të lexoni më poshtë. Ju faleminderit

Unë jam Dineta. Këtë artikull do ta fillojmë duke iu treguar një shembull nga jeta ime e përditshme. Një zgjedhje e vështira e imja është zgjedhja në familje. Zgjedhja në mes të anëtarëve të familjes është zgjedhja më e vështirë jo vetëm për mua, por për të gjithë fëmijët në botë. Po flasim për prindërit. Shpesh herë njerëzit më pyesin se cilin prind e dua më shumë. Kjo është zgjedhja më e vështirë dhe më e lodhshme për të gjithë, sepse të dy janë prindër të cilët i duam shumë. Ata më rritën dhe kujdesen çdo ditë për mua. Kështu që unë nuk mund t'i dalloj ata.



Një ditë me shokun tim po flisnim për librat tona të preferuara. Pasi shoku im u largua, unë mendova për një libër të cilin dëshiroja ta lexoja. Derisa isha me shokun tim, ai po më fliste për një libër që sapo e kishte lexuar. Unë mendova ta marrë atë, sepse po e përshkruante shumë bukur. Ky ishte libri „Beni ecën vetë“. Kurse unë po mendoja për librin „Liza në botën e çudirave“. Kështu unë vendosa që njëherë ta lexoj librin e shokut, e më vonë librin tim. Kjo zgjedhje ishte e vështirë për mua, por më erdhi mirë që shoku më ndihmoi. Unë jam Vigan dhe ky është shembulli im për zgjedhjet shoqërore. Tani do të flas shoqja ime Erza për zgjedhjet demokratike të cilat ndodhin në vendin tonë.



Shumë shpesh neve si nxënës na bie të zgjedhim cilin libër duam ta lexojmë. Kjo zgjedhje nuk është e lehtë asnjëherë, sepse ne duam të lexojmë çdo libër në botë

Pasi erdhëm në „Demos-ti“, ne filluam të diskutonim për zgjedhjet. Kjo temë nuk ishte krejtësisht e njohur për ne. Disa gjëra i dinim edhe më parë, kurse të tjerat i mësuam sot. Ne mësuam se deputetët votojnë Kryetarin e Kuvendit, Presidentin dhe Qeverinë. Kurse janë qytetarët, ata të cilët i votojnë deputetët. Këto janë

zgjedhjet parlamentare dhe organizohen çdo 4 vjet. Zgjedhjet komunale janë zgjedhjet ku ne votojmë për kryetar të komunës dhe asamblistët. Edhe këto zgjedhjet mbahen çdo 4 vjet. Vota duhet të jetë e lirë, e fshehtë dhe anonime. Ne premtojmë se kur të arrijmë moshën 18 vjeçare do të dalim të votojmë.



DUART E ARTA TË QYTETARËVE AKTIV

DORARTA (11), SHPEND (11), YLLËZA (11), BLENDA (10), ENES (11), ERIS (10)



E ardhmja e popullit është në duart e qytetarëve aktiv. Por, a e dini ju se çfarë duar kanë këta qytetarë? Këtë do ta mësoni nga ne, grupi „Yjet“

Qytetarët aktiv japin më të mirën e tyre për të ndihmuar të tjerët. Ata kanë të drejtën e votës dhe e shfrytëzojnë këtë të drejtë. Ata mendojnë për të ardhmen e shtetit të tyre dhe kanë shumë vullnet që ta zhvillojnë atë. Ata mendojnë edhe për pastërtinë e vendit të

zinë, tolerancën, solidaritetin, respektin, etj. Ata janë shumë të preokupuar me barazinë, dhe mundohen që gjithmonë ta promovojnë atë. Të gjitha njohuritë që ata i marrin, i ndajnë me të tjerët, sepse këta qytetarë e dijnë vlerën e të qenurit i informuar mirë. Ata janë zemërmirë dhe zemërgjerë, nësoj si shoku ynë Shpendi, të cilin mund ta shihni në fotografinë e bashkangjitur në këtë artikull.

Edhe pse jemi të vegjël, ne mundohemi të jemi aktiv. Kemi shumë raste kur: iu kemi ndihmuar të varfërve, kemi pastruar ambiente të ndryshme, iu kemi ndihmuar të moshuarve, kur kanë pasur nevojë, si dhe kemi organizuar programe të ndryshme shkollore. Të gjitha këto i kemi bërë nga vullneti ynë dhe nga dëshira për të qenë sa më produktiv në komunitetin tonë. Ne si qytetarë duhet të jemi gjithmonë aktiv dhe kjo është porosia nga ne, grupi „Yjet“. Mos harroni se qytetarët aktiv kanë duar të arta!



Kjo është zemra e madhe e qytetarëve aktiv

tyre. Qytetarët aktiv nuk harrojnë të paguajnë taksat e shtetit, ata hapin edhe OJQ nëse kanë ndonjë ide të mirë dhe të rëndësishme për vendin e tyre. Qytetarët aktiv hapin edhe qendra mjekësore, por nuk e harrojnë arsimin, pasi që ata hapin edhe qendra edukative për të mirën e fëmijëve, arsimimin dhe edukimin e tyre. Qytetarët aktiv marrin pjesë në tubime publike dhe në zgjedhje, vetëm për të mirën e përgjithshme të shtetit. Ata i zbatojnë elementet e demokracisë si: bara-



A po dukemi si yje? Vlerësojeni vetë këtë gjë!



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Thimi Mitko“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan